



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 598 / Prot.

Tiranë, më 23.09. 2015

V E N D I M

Nr. 101 , datë 23/09/2015

“Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar mbi bazën e ankesës së *** , me Nr. 598 Prot., datë 19.08.2015”**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 16 e 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të dokumentacionit administruar me shkresën nr. 598 datë 19.08.2015,

VËREJ SE:

Në datën 19.08.2015, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka mbërritur informacioni i përcjellë nga ***** me Nr. 598 Prot., në lidhje me ankesën për mosekzekutimin e vendimit nr. 27, datë 29.02.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë, që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 227, datë 30.11.2011, të ish Komisionit të Shërbimit Civil.

***** ka filluar punë me aktin e përkohshëm nr. 12, datë 09.09.1996, në pozicionin e Sekretares së Kryetarit të Bashkisë Tepelenë dhe Përgjegjëses së Administratës-Protokollit dhe është konfirmuar si nëpunëse civile me aktin nr. 13 datë 12.12.2004.

Nga ky pozicion pune është larguar me aktin nr. 77, datë 04.10.2011, të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, për lirimin nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit. Për këtë arsye, ankuesja i është drejtuar me shkresë ish Komisionit të Shërbimit Civil, i cili, me vendimin nr.227, datë 30.11.2011, ka vendosur:

“1. Pranimin e ankesës së ***** .

1. *Shfuqizimin e aktit nr.77, datë 04.10.2011, të kryetarit të bashkisë Tepelenë “Për largimin nga detyra të nëpunësit”.*
2. *Rikthimin e ankueses në detyrën e mëparshme, Përgjegjëse e Administratës dhe Sekretare e Kryetarit në Bashkinë Tepelenë.*
3. *Kryerjen e pagesës së plotë të ankueses, nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare e deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi...”*

Me vendimin nr. 27, datë 29.02.2012, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 227, datë 30.11.2011, të Komisionit të Shërbimit Civil. Në zbatim të këtij vendimi, i cili përbën titull ekzekutiv, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datë 08.05.2012, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën civile me nr. 5307 akti, ka vendosur: *“Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për Vendimin nr.227, datë 30.11.2011, të KSHC të lënë në fuqi me Vendimin nr. 27, datë 29.02.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë”.*

Bazuar në këtë urdhër ekzekutimi (*lëshuar me aktin nr.5307 datë 08.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*) dhe në faktin se nga ana e institucionit debitor është refuzuar zbatimi vullnetar i urdhërit të ekzekutimit, paditësja i është drejtuar zyrës përbarimore private me Përbarues Gjyqësor Privat ***** . Ky i fundit, në cilësinë e organit kompetent ekzekutues, i është drejtuar subjektit debitor me kërkesë për ekzekutim vullnetar të detyrimeve që ka ndaj ankueses, korrespondencë e cila ka vijuar me vënien e sekuestros konservative më datë 16.11.2012 nga ana e përbaruesit ndaj subjektit debitor Bashkia Tepelenë. Por Bashkia Tepelenë përsëri ka refuzuar zbatimin e plotë të gjithë urdhërimeve që përmban titulli ekzekutiv, dhe prej përbaruesit po vijon puna për plotësimin e detyrimeve prej debitorit.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se jemi para një rasti ku gjykata është shprehur me vendim përfundimtar të formës së prerë, i cili është kthyer në titull ekzekutiv. Organi kompetent përbarimor po vijon kryerjen e veprimeve për zbatimin e plotë të gjithë urdhërimeve që përmban titulli ekzekutiv.

Referuar parimit të sanksionuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile, se institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, si dhe nga fakti që titulli ekzekutiv në fjalë është në ekzekutim e sipër nga ana e organit kompetent përbarimor, vlerësoj se nuk ka vend për t’u investuar apo ndërhyrë nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenin 14 të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores *“Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, të miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A :

1. Përfundimin e procedimit administrativ për verifikimin e ankesës së punonjësës ***** .
2. Të njoftohet për këtë vendim shtetësja *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA